

RAPORTI I DYTË MBI PUNËN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Për shkak të obligimeve programore;

Me qëllim të informimit të komunitetit të aftësisë së kufizuar, si dhe të institucioneve komunale për punën dhe aktivitetet e veta gjatë periudhës njëvjeçare;

Në transparencë; dhe

duke iu përmbajtur kontinuitetit në raportim, Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara i Komunës së Prishtinës, publikon këtë:

R A P O R T MBI PUNËN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E PRISHTINËS PËR VITIN 2018

(I) PJESA HYRËSE

Përmbajtja e këtij raporti përfshin punën, aktivitetet, mbledhjet dhe takimet e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara të Komunës së Prishtinës (më tej në tekst: Komiteti), për periudhën janar-dhjetor 2018.

Gjatë periudhës raportuese, Komiteti ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje, ka pasur më së pesë (5) takime me përgjegjësit digasterial të drejtorive komunale dhe udhëheqës kompanish publike, si dhe ka marrë pjesë në punimet për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020 për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës, në kuadër të projektit “Punësim dhe drejtësi për personat me aftësi të kufizuara”.

Realiteti aktual është ende larg realizimit të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (më tej: PAK).

Ata janë grupi më i marginalizuar i shoqërisë, të cilët nuk mund t'i realizojnë të drejtat e veta ligjore dhe më elementare, përfshirë edhe të drejtën në punësim, ani pse ligjshmërisht, çdo i pesëdhjeti i punësuar duhet të jetë PAK, ose 2% e të punësuarve.

Burimet e raportit janë ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve/takimeve të Komitetit.

Raporti, pas miratimit në mbledhje të Komitetit, do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komunës së Prishtinës.

(II) PJESA TEMATIKE

1. MBLEDHJET

1.1. Mbledhja e parë e Komitetit (05.03.2018)

Pjesëmarrës në mbledhje ishin: Mehreme Llumnica, Kryesuese e Komitetit, Ramadan Salihu, Fatime Demolli, Armend Ademi dhe Enver Hasangjekaj, anëtarë, si dhe Premtime Preniqi, Koordinatorë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Tema debati të kësaj mbledhjeje kanë qenë:

- Plani i Punës së Komitetit për vitin 2018; dhe
- Shqyrtimi i formës së aplikacionit për projekte të mundshme për Komitetin.

I. Rreth Planit të Punës së Komitetit për Vitin 2018, pati propozime dhe u ngritën këto çështje:

• **Orari i mbledhjeve të Komitetit** – Pati propozime që mbledhjet e parapara të mbahen në javën e fundit të muajit gjatë pjesës së parë të vitit, të përcaktohen për një termin tjetër kohor, ose të mos caktohet fare termini, por të lihet kjo në bazë të mundësive reale.

U vendos që megjithatë mbledhja të mbahet në terminin kohor të paraparë me Plan të Punës.

• **Tryeza e Rrumbullaktë.** - Për shkak të mosmbajtjes me kohë të mbledhjes së Komitetit, ka bërë që të ngelet pak kohë për përgatitjen e Tryezës së Rrumbullakët, në kohën e paraparë me Planin e Punës. Koha e mbajtjes së saj sipas planit është afër dhe në tryezë duhet të ftohen një numër pjesëmarrësish, të cilët janë kompetentë për zbatimin, përkatësisht, monitorimin e zbatimit të legjislacionit për punësim, si: Avokati i Popullit, Këshilli për të Drejtat e Njeriut, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, drejtoritë përkatëse komunale.

Pati mendime se, për shkak të numrit të madh të pjesëmarrësve, tryeza nuk mund të mbahet këtu në këtë sallë, por në hotel apo ndonjë vend tjetër.

U debatua edhe rreth kostos së tryezës, si dhe për gjetjen e donatorëve.

Një mendim rrodhi që tryeza do të duhej mbajtur në ditën e shënimit të 12 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Prishtinës. Atë ditë të dilet se si po zbatohet gjithë legjislacioni për të drejtat e PAK. Por, kishte mendime që tryeza të mbahet edhe me rastin e shënimit të 1 Majit.

Për panelistë, u vendos që, nga ana e Komitetit të jetë Ramadan Salihu, kurse të ftuar të jenë: Kryetari i Komunës, Drejtori i Administratës, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Menaxheri i Personelit, Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit, si dhe përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale.

• **Turniri i Shahut** – Data e 12 Qershorit, që është paraparë me Plan të Punës për turnir shahu është afër dhe organizimi kërkon kohë. Janë paraparë garat në shah dhe duhet ditur sa garues janë, cila është kostoja, sa ditë mbahen garat, etj.

Për të mos hyrë në vonesë, u vendos që të shkohet në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për të biseduar për mundësinë e financimit të këtij turniri.

• **Shënimi i 3 Dhjetorit (Dita Ndërkombëtare e PAK)** – Sugjerimi i parë lidhur me këtë datë doli që të mos emërohet manifestim, sepse nuk është festë, por të mbahet një takim ose të dilet me një kampanjë promovuese, si: udhëtimin, infrastrukturën, shkollimin për PAK, e të tjera, kështu që të ketë sa më shumë aktivitete, e jo vetëm sa për ta bërë një shënim.

II. Forma dhe mundësia e aplikacionit për projekte të mundshme për Komitetin, nxorri diskutimet si më poshtë:

• **Vizita etniteteve homologe** – Debati këtu u fokusua rreth aplikacionit për grant, të cilin e ka punuar Ramadan Salihu dhe e ka dorëzuar në Komitet për procedura të mëtejme. Nga folësit u potencua se është kryer afati i aplikimit për grante në KSCF, aty ku ka qenë adresa e aplikacionit. Vështirësi tjetër, siç u përmend këtu, është fakti se Komiteti nuk është OJQ, që është kusht paraprak për donatorët.

Megjithatë, kishte mendime se mund të aplikohet edhe në GIZ-in Gjerman, ku qenka një konkurs për grante. Por, u tha se ato grante parashihen më shumë për shtresat e varfëra, me përparësi komuniteti RAE, boshnjakë, etj. Konkursi është i hapur gjer më 31 mars. Në faqen e internetit të GIZ janë të gjitha të dhënat.

Zyrtarja komunale njoftoi se Komuna e Prishtinës ka shumë projekte me GIZ-in e ndër to ka edhe për grupet e marginalizuara. Një i tillë ka qenë vitin e kaluar, i cili ka pasur të bëjë me qasjen e PAK.

Pasi që nuk bëhet fjalë për një OJQ, po për Komitetin, dominoi mendimi atëherë se duhet drejtuar me kërkesë Kryetarit të Komunës.

Duke qenë se afatet për aplikim janë ende të hapura, u vendos që, përveç kërkesës Kryetarit të Komunës, të aplikohet edhe në KCSF dhe në GIZ.

Ndër të tjera, në mbledhje u ngritën edhe këto çështje:

- Lirimi nga pagesa e biletës në Trafikun Urban;
- Sa nxënës të shurdhër janë në shkollat e Prishtinës, që janë gjithsej 20 sosh? Nxënësi i shurdhër që shkon në shkollë në gjithëpërfshirje ka mundësi të jetë i pazhvilluar për shkak të mungesës së Gjuhës së Shenjave. Andaj, nxënës të tillë të identifikohen dhe të trajtohen në Gjuhën e Shenjave, që të mos ketë ngecje të asaj natyre. Parësore për të shurdhërit është gjuha;
- Mospranimi i një personi të shurdhër në punë në Komunë. Ka qenë një person i shurdhër që ka aplikuar për punësim në Shkollën Fillore “Elena Gjika”, ka dy muaj që ka pritur dhe nuk ka marrë përgjigje. Ndërkohë ka kuptuar se është punësuar një person i cili dëgjon. personi ka konkurruar për mirëmbajtës. përgjigje s’ka marrë dhe në intervistë nuk është ftuar;

- Nuk po zbatohet Udhëzimi Administrativ 19/20, i vitit 2016, për lirim nga pagesa për fëmijë me nevoja të veçanta në Institucionet Parashkollore;
- Drejtoria Komunale e Arsimit fëmijë me nevoja të veçanta i adreson vetëm në Kopshtin "Gëzimi Ynë" e jo edhe në kopshte tjera;
- Mungesa e anëtarëve të Komitetit nëpër takime, tryeza a punëtori, ku debatohet për çështje të rëndësishme, veçmas për arsimin, si dhe Planin e Veprimt;
- Një gabim në Raportin Vjetor të Komitetit, të publikuar në ueb-faqen e Komunës.

Duke filluar nga kjo e fundit, **u dhanë** sqarime se, nga interpretimi ose edhe nga shkrimi, është lëshuar një gabim teknik në raport, lidhur me interpretimin e një fjalie të Armendit, por Armendi nuk ka reaguar me kohë dhe fjalia me atë lëshim ka mbetur e publikuar në faqe të internetit.

U dakordua për caktimin e një takimi me Drejtorin Ekzekutiv të NP "Trafiku Urban", për çështjen e lirit nga pagesa e biletës në transportin publik. Ndërsa, gjer në rregullimin përfundimtar të kësaj çështjeje, mbetet vetëm që PAK t'ua tregojnë konduktorëve dokumentin identifikues të aftësisë së kufizuar.

Përveç moszbatimit të Udhëzimit Administrativ për lirim nga pagesa për fëmijë me nevoja të veçanta në Institucionet Parashkollore, në fushën e arsimit në komunë ka ngecje edhe në realizimin e të drejtave tjera të PAK, si: nuk ka kuadër të mjaftueshme në Institucione Parashkollore për të punuar me fëmijë me nevoja të veçanta, nuk ka as inspektorë të mjaftueshëm që e njohin fushën e PAK. Për këto tema u vendos që Komiteti ta vizitojë Drejtorinë Komunale të Arsimit.

** Si rezultat i debatit, njëzëri u miratua Plani i Punës së Komitetit.*

1.2. Mbledhja e dytë e Komitetit (14.05.2018)

Në mbledhje morën pjesë: Mehreme Llumica, Kryesuese e Komitetit, anëtarët: Ramadan Salihu, Fatime Demolli, Armend Ademi dhe Enver Hasangjekaj, Premtime Preniqi, Koordinatorë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, si dhe Mevlude Zejnullahu, Zyrtare e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Çështjet për shqyrtim në këtë mbledhje janë:

- o Organizimi i aktivitetit sportiv në disiplinën e shahut (Turneu i Shahut); dhe
- o Problemet me transportin publik pa pagesë për PAK.

I. Në lidhje me turnirin e shahut, u zhvilluan debate me përmbajtje si në vijim:

• Refuzimi i kërkesës për financim të turnirit në shah. – Enver Hasangjekaj, anëtar i Komitetit, njoftoi të pranishmit se nga ana e Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, kërkesa për financim të turnirit të shahut është refuzuar, me arsyetim se aplikimi është jashta afatit për shpallje publike për grante dhe subvencione të Komunës.

Pas këtij njoftimi pasuan paraqitjet e të pranishmëve, në kuptim të asaj se:

- Projekti në fakt nuk është refuzuar, por është dorëzuar pas afatit për shpallje publike, ndaj dhe s'është shqyrtuar fare;
- Plani i Punës së Komitetit është miratuar në muajin mars dhe sipas këtij programi është dashur më herët të merremi me këtë punë;
- Në takimin e Komitetit me Drejtorin e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport është përkrahur plotësisht ky projekt, madje me mundësinë që një turnir i tillë të jetë tradicional;
- Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport jep grande, por donacionet që i japin e kanë afatin e kufizuar, sepse ajo shkon përmes prokurimit;
- Komiteti nuk ka qenë në dijeni se është afati i caktuar për aplikim;
- Përderisa është fjala për PAK, është e besueshme se e financojnë këtë turnir, sepse kanë konsideratë për organizimin e këtij aktiviteti;

• **Vizita entiteteve homologe** – Meqenë se Zyrtarja e Drejtorisë së Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, znj. Mevlude Zejnullahu, erdhi më vonë për t'iu përgjigjur ftesës së Komitetit për mbledhje, atëherë, debati u orientua rreth një vizite pune që sipas Planit të Punës së Komitetit, është paraparë t'u bëhet

entiteteve homologe jashta vendit, për t'i parë përvojat në lidhje me temën e aftësisë së kufizuar, trajtimit të kësaj çështjeje në nivelin lokal, ndërlidhjes së atyre entiteteve dhe institucioneve shtetërore, të OJQ-ve dhe të individëve. Këtë lloj vizite, e cila është në program, Komiteti nuk mund ta realizojë përmes donatorëve, për arsye se nuk është OJQ. Atëherë, mbetet që përmes institucioneve të shqyrtohet mundësia për realizim të vizitës.

Zyrtarja komunale u shpreh se nuk është personi kompetent ta shtyjë këtë projekt deri në vend. Mirëpo, si pjesë e Komunes premtoi se do të përpiqet për ta adresuar projektin. Duhet biseduar me kolegët e Drejtorisë së Shëndetësisë, mos kanë ndonjë fond për ta ndarë, sepse kanë fonde edhe për kategori të tilla. Ajo pyeti se a është caktuar ndonjë vend për vizitën.

Përgjigja ishte se nuk është caktuar vendi, por patjetër se do të jenë nga vendet me të drejta të avancuara për PAK. Znj. Zejnullahu përfundoi se mbetet që ta marrë projektin e së bashku me Premtimen të përpiqen të gjejnë ndonjë mundësi.

Gjithashtu, u shtrua pyetja lidhur me Qendrën e Karrierës, në të cilën pritej një projekt prej Unionit Evropian dhe ka qenë fjala që komuniteti i aftësisë së kufizuar të përfitojë nga ai projekt. Ndërsa përgjigja ishte se jemi duke pritur dhe shpresojmë se do të realizohet.

** U vendos që, për turnir në shah, në formë të protokoluar dhe përmes e-mailit t'u dërgohen dy kërkesa të njëjta, njëra t'i dërgohet Kryetarit të Komunes, e tjetra Drejtorit të Drejtorisë së Administratës.*

** Gjithashtu, u dakordua që tryeza të mbetet në muajin tetor. Muaji tetor quhet "Muaj i mundësive të barabarta", kryesisht për punësimin e PAK dhe këtë gjithëherë e financon Komuna si projekt për këta persona.*

II. Përkritazi me problemet me transportin publik pa pagesë për PAK është folur edhe më parë. Është potencuar se NP "Trafiku Urban" ka bërë një marrëveshje me HANDIKOS-in për lirim nga pagesa për PAK. Por, një marrëveshje e tillë ka të bëjë vetëm me një lloj të aftësisë së kufizuar dhe Komiteti do të duhej të angazhohej që edhe llojet tjera të aftësisë së kufizuar të jenë po ashtu të liruar nga pagesa në trafikun urban. U potencua se në shkresë për lirim nga pagesa vendosur në autobusët e këtij trafiku, fjala "hendikep" që ka qenë përpara, tani ishte "Hendikos", pa pasur një diskutim me komunitetin.

Në vazhden e debatit, u shpërfaqen edhe këto opinione:

- Kërkohej një kartelë/librezë nga shoqata përkatëse për identifikim të PAK për lirim nga pagesa, por, ka shoqata që nuk lëshojnë asi lloj të dokumentit, siç është Shoqata e Autizmit që nuk lëshon kartelë për fëmijë me autizëm. Kurse, është e ditur se autizmi është specifikë kryesisht të fëmijët
- Ka PAK që nuk dallohen që janë PAK, andaj duhet pasur një dëshmi. Me një dokument nga mjeku ose Enti për Mirëqenie Sociale, që e dëshmon se është PAK, i drejtohet "Trafikut Urban" dhe e merr një kartelë;
- Edhe me librezën e HANDIKOS-it të gjithë PAK nuk trajtohen si të tillë nga ana e konduktorëve, nëse nuk i shohin me dëmtime fizike, me karrocë apo me paterica, etj;
- PAK me ligj është i liruar nga pagesa e udhëtimit. "Trafiku Urban" është kompani profitabile dhe ajo ka për interes që të ketë kompensim për fitimin e humbur nga kjo mospagesë e biletave. Andaj, Komuna është dashur të japë një subvencion për këtë;
- Të gjitha OJQ-të kanë librezë të anëtarësisë. E përderisa është një librezë e anëtarësisë, e konsideron si PAK edhe konduktori e kushdo që është. Derisa në ato kartela shënon jo "Hendikos" por PAK, kjo nënkupton që pa e nda asnjë aftësi të kufizuar. Nuk bëjnë problem as nëse personi është i shurdhër, kur ai e tregon librezën e anëtarësimin;
- Pa udhëheqësinë e Ndërmarrjes "Trafiku Urban" nuk mund të bëhet asgjë. Duhet takuar me ta dhe ata na orientojnë më tutje. Por, edhe nëse rregullohet kjo çështje me Ndërmarrjen "Trafiku Urban", bëhet fjalë për lirim vetëm për linjën 3 dhe 4, e kjo është gjysma e punës. Andaj, bisedat duhet të zhvillohen se si të mos ketë probleme për lirim nga pagesa edhe për linjat tjera komunale.

** U vendos që, në emër të Komitetit, t'i bëhet një vizitë NP "Trafiku Urban", me qëllim të shqyrtimit të lirim të të gjithë PAK nga pagesa e biletës së udhëtimit.*

Nën “Të ndryshme”, u shpreh pakënaqësi lidhur me çështjen e moslirimit të prindërve nga pagesa për fëmijë me nevoja të veçanta në qerdhe. Për këtë problematikë pasuan reagimet, si:

- Në emër të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, i është dërguar një kërkesë Drejtorit të DREJTORISË KOMUNALE TË ARSIMIT,. Në “HANDIKOS” është edhe grupi avokues i nënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, nga i cili grup i janë dërguar tri kërkesa drejtorit, por të cilave nuk u është përgjigjur. Mirëpo nënat kanë qenë insistive dhe janë takuar me drejtorin. ato i kanë paraqitur këto probleme: transportin, regjistrimin, lirim nga pagesa, mësuesve mbështetës, komisionin, si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me arsimin, etj;
- Kemi qenë si Komitet tek Drejtori Jonuz Salihaj dhe një ndër pikat kyçe kemi diskutuar me të çështjen e pagesës së fëmijëve në Institucione Parashkollore. Dhe i njëjti drejtor ia nënshkruan prindërit refuzimin e kërkesës për lirim. Kjo është befasi. Atëherë, pse mos të vlerësohet fjala jonë si Komitet, kur ne flasim vetëm për zbatimin e legjislacionit dhe asgjë nuk veprojmë jashta tij. Ai është drejtor i një drejtorie dhe kjo nuk do të thotë të jetë në vullnetin e tij që ta lirojë a mos ta lirojë një prind nga pagesa për fëmijun e tij me aftësi të kufizuara. Ligji e parasheh të lirohet.

** Ndonëse u potencua se Komiteti është organ këshillëdhënës dhe informues dhe nuk është vendimmarrës, megjithatë u vendos që të llobojë për zbatimin e akteve të ligjshme për lirim nga pagesa për qerdhe për fëmijë me aftësi të kufizuara.*

1.3. Mbledhja e tretë e Komitetit (07.09.2018)

Në mbledhje morën pjesë: Mehreme Llumnica, Kryesuese e Komitetit, anëtarët: Ramadan Salihu, Fatime Demolli, Armend Ademi dhe Enver Hasangjekaj, si dhe Premtime Preniqi, Koordinatorë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Në këtë mbledhje u propozuan dhe u miratuan këto pika:

- o Gjashtëmujori i parë i Planit të Punës së Komitetit, të arriturat dhe ngecjet; dhe
- o Mundësia e pjesëmarrjes së anëtarëve të Komitetit në seanca të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

II. Në lidhje me Planin e Punës së Komitetit për gjashtëmujorin e parë, u fol për të arriturat dhe ngecjet e Komitetit. Si dështime u kualifikuan disa nga këto planifikime:

• **Projekti i turnirit në shah** – Për shkaqet e dështimit dhe për mundësitë tjera në të ardhmen, erdhën në shprehje këto pikëpamje:

- Turniri ka dështuar pasi ka kaluar afati kohor për aplikim në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport. Por, Drejtori i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport e ka kthyer përgjigjen përmes e-mailit me informatën se në muajin gusht - shtator do të ketë prapë shpallje publike, andaj Komiteti duhet të interesohet për këtë;
- Duhet përshtatur kohën kur ka shpallje publike. Jashtë afatit është i kotë aplikimi;
- Për shkak të vonesës, e cila ka bërë të pamundur mbajtjen e turnirit në kohën e përcaktuar në Planin e Punës, ky projekt të mbetet për vitin tjetër. Projekti i kushtohet Ditës së Çlirimit të Prishtinës, ndaj, si i tillë ka një simbolikë dhe rëndësi të veçantë. Duhet pasur kujdes në të ardhmen për t’iu përmbajtur orarit të programit i cili është miratuar këtu;
- Nëse mendohet të riaplikohet tash, duhet bërë gjithsesi disa ndryshime. Aty ku thuhet për “Ditën e Çlirimit të Prishtinës”, mund të thuhet për “Muajin e Mundësive të Barabarta”, që për aftësinë e kufizuar mbahet në tetor.

• **Projekti i Tryezës së Rrumbullaktë.** - U theksua se:

- Tryeza është pjesë e Planit të Punës, e ka të përcaktuar datën e mbajtjes dhe duhet respektuar atë. Mirëpo, pasi ka ardhur kështu gjendja, me vonesa në realizim, po vendosim siç u propozua, që të mbahet me rastin e “Muajit të Mundësive të Barabarta”. Herave tjera, tryezën e organizojmë ashtu siç është planifikuar – për 1 Maj;
- Në tryezë, duhet të ftohen të gjithë ata që janë përmendur edhe më përpara, si: Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Avokati i Popullit, Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i Drejtorisë

së Arsimit, Drejtori i Administratës, Shefi i Personelit, Shefi i Zyrës Ligjore, Qendra për Punë Sociale, Forumi i PAK, përfaqësues të OJQ-ve të PAK, si dhe mediet;

- Për tu kryer kjo punë, kërkon njerëz dhe buxhet. Komiteti së pari buxhet nuk ka. Kush ka për ta financuar këtë projekt.

• **Raporti mbi të Gjeturat rreth Punësimit të PAK në Prishtinë.** - Në kuadër të HANDIKOS-it, është hartuar një raport informues mbi të gjeturat e punësimit të PAK në sektorin publik dhe privat në Komunën e Prishtinës. Në këtë projekt kanë marrë pjesë anëtarët e Komitetit edhe nga një anëtar nga pesë llojet e aftësive të kufizuara. Pastaj, është planifikuar në lidhje me këtë një tryezë e rrumbullakët, për t'i prezantuar këto hulumtime. Kjo ndoshta do të kishte një jehonë më të madhe për "Muajin e Mundësive të Barabarta". Është domethënëse që kjo tryezë të mbahet në muajin tetor, por na duhet koordinimi me Komunën për kohën, panelistët, etj. U propozua dhe u miratua që një nga anëtarët, si përfaqësues i Komitetit, të prezantojë në medie lidhur me raportin e hulumtimit. Është me rëndësi prezantimi nga një PAK.

Lidhur me këtë, si Komitet, të paraqitet kërkesa në Kuvendin e Komunës, për ta zhvilluar tryezën para asambleistëve. Aty janë edhe mediet. Kështu që duhet takuar me z. Agim Kuleta, për ta njoftuar atë që Komiteti ka bërë këtë hulumtim, të cilin dëshirojmë ta prezantojmë para asambleistëve. Kjo hyn si pikë e rendit të ditës për asamble. Po ashtu, kjo edhe e plotëson këtë mundësinë e pjesëmarrjes në seanca dhe asambleistëve u tregojmë që ekzistojmë.

Nën "Të ndryshme", Armend Ademi, anëtar i Komitetit, i paraqiti rekomandimin që është mirë të jemi të lirë të punësohemi, kush e qysh mundemi. Pra, të mos jetë ashtu siç parashihet në ligj që në çdo pesëdhjetë të punësuar, një duhet të jetë PAK. Për këtë propozoj ta bëjmë një ankesë në Forumin e PAK, që të hiqet ajo kuota 50 me 1. Një rekomandim i tillë nuk kaloi.

Në fund të mbledhjes, u vendos që të caktohet:

* *Takim me Kryesuesin e Asamblesë Komunale të Prishtinës – me qëllim të shqyrtimit të mundësisë për pjesëmarrje të Komitetit në një mbledhje të asamblesë; si dhe*

* *Takim me Forumin e Aftësive të Kufizuara – me qëllim QË të njihet roli dhe funksionimi i atij forumi, si dhe mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë.*

1.4. Mbledhja e katërt e Komitetit (14.11.2018)

Në mbledhje morën pjesë: Mehreme Llumnica, Kryesuese e Komitetit, anëtarët: Ramadan Salihu, Fatime Demolli, Armend Ademi dhe Enver Hasangjekaj.

Për këtë mbledhje u propozuan dhe u miratuan këto tema:

- Diskutim rreth pjesëmarrjes së anëtarëve të Komitetit në seancën e nëntë të Kuvendit të Komunës; dhe
- Nevoja dhe mundësia për monitorimin e implementimit të legjislacionit për punësimin e PAK dhe të rekomandimeve për punësimin e tyre, të miratuara në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

I. Lidhur me diskutimin rreth pjesëmarrjes së anëtarëve të Komitetit në seancën e nëntë të Kuvendit të Komunës, Mehreme Llumnica theksoi se pas shumë përpjekjeve të Komitetit, në bashkëpunim me z. Agim Kuleta, Kryesues i Kuvendit, është arritur të futet raporti si pikë e rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit. Ishte një ndjenjë e veçantë pjesëmarrja në mbledhje të Kuvendit të Komunës. Raporti është prezentuar shumë mirë dhe drejt. Prezantimi ynë aty do të jetë sensibilizues në të ardhmen, por edhe një rritje e vetëdijes së asambleistëve dhe qytetarëve.

Debati u pasurua me këto paraqitje:

- Ne po luftojmë për një pozitë më të mirë për shtresat më të margjinalizuara. Atyre u mungojnë vendi i punës, ekzistenca dhe nevojat elementare që i kanë;
- Në mbledhje e kuptuam që Kuvendi i Komunës nuk na njeh si entitet i brendshëm institucional komunal, si pjesë e Komunës. Asambleistët në vijimësi e bartnin idenë se këta janë qytetarë që po i qajnë hallet e veta të ne. Kjo duhet të ndryshojë. Pra, ne, sikurse ata vetë, ishim aty një pjesë e Kuvendit, që debatonim një

problem specifik. Është ai hendeku në mes të aftësive të kufizuara dhe institucioneve, sa që ata as Komitetin nuk e dinin si diçka të organizuar, si një entitet i cili është zgjedhur nga vetë ata për një fushë të caktuar. Falenderojmë Kryesuesin e Kuvendit, z. Agim Kuleta, i cili, në bashkëpunim me z. Osman Bllaca, në të gjitha format ishte i interesuar qoftë si entitet komunal, qoftë si OJQ, qoftë si grup qytetarësh, që çështja e aftësisë së kufizuar të sensibilizohet. Ata kanë bërë gjithçka që Raporti të futet në rend dite. Është meritë edhe e HANDIKOS-it, i cili ka kontribuar që raporti të finalizohet dhe të paraqitet në Kuvend. Është mirë të shfrytëzohet ky momentum në funksion të sensibilizimit të çështjes së aftësisë së kufizuar. Por, duhet një artikulum më i qartë i individit PAK, i OJQ-ve që i përfaqësojnë, i Komitetit, si dhe gjithë atyre që merren me aftësinë e kufizuar, në lidhje me nevojat, kërkesat dhe të drejtat e PAK. Ka një dallim mes nevojave dhe të drejtave të individit PAK dhe kërkesave të OJQ-ve për funksionim. Në këtë drejtim, kërkoj në mënyrë kolegjiale të japim kontributin, ashtu siç ka qenë një punë me elan në fillim të paraqitjes së Komitetit, në mënyrë që të rritet roli i tij në funksion të qartësimit të realizimit të normativës komunale për realizimin e të drejtave të PAK në nivelin koemunal;

- Është një plus që raporti ka dalë para opinionit për të treguar për atë se çka përfaqëson Komiteti. Por, është me interes të dihet se a ka pasur pyetje nga asambleistët drejtuar përfaqësuesit të Komitetit pas prezantimit, si dhe a është publikuar në ueb-faqe të Komunes diskutimi i prezantuesit.

Pas mbarimit të diskutimit, **Kryesuesja e komitetit** informoi se prezantimi i Raportit të Punësimit në Kuvendin e Komunës nga ana e Komitetit, përkatësisht, diskutimi i anëtarit të tij, mund të gjindet në You Tube, tek Mbledhja e Nëntë e Kuvendit të Komunës, të dt. 31.10.2018, ku është incizimi i debatit dhe konkluzionet që kanë dalë.

II. Për nevojën dhe mundësinë për monitorimin e implementimit të legjislacionit për punësimin e PAK dhe të rekomandimeve për punësimin e tyre, të miratuara në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, u tha:

- Rekomandimet tona t'u përcillen OJQ-ve, në mënyrë që në koordinim me to të kërkohet prej ndonjë fondacioni për të na ndihmuar në implementimin e rekomandimeve. Po ashtu, rekomandimet që janë dhënë në asamble nga ana e Komitetit, të bëhen publike në medie;
- Në kuadër të projektit, përfaqësuesi i Komitetit ka qenë mysafir në një program të mengjesit në KTV, në të cilin ka prezantuar të gjeturat e raportit dhe rekomandimet e tij. Mirëpo, nëse na lënë hapësirë mediet, do të ishte mirë t'i dedikohet një program vetëm raportit dhe rekomandimeve;
- Një ndër takimet e ardhshme të Komitetit të jetë edhe me OJQ- të e aftësive të kufizuara, në mënyrë që ato të jenë më proaktive në këtë monitorim. se është madje edhe punë e tyre avokimi dhe monitorimi i punësimit të anëtarëve të vet PAK. OJQ-të kanë të dhëna më të plota rreth punëkërkuësve Pak, profesioneve të tyre dhe të vendeve të punës që mund të jenë për ta. Komiteti është për këshilla rreth normativës, propozimeve, ideve dhe rregulloreve në Komunë, se a janë në përputhje me legjislacionin dhe me nevojat e PAK;

Të mbahet një takim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe me Zyrën e Prokurimit, me idenë që, kur të shpallin tendërë, të inkurajohet punësimi i PAK, duke u ofruar benefite atyre kompanive me rastin e aplikimit dhe fitimit të tendërit, siç e ka bërë Komuna në aplikacionin për punësim. Pra, Drejtoria e Shërbimeve Publike së bashku me Zyrën e Prokurimit dhe Zyrën Ligjore, të kushtet dhe kriteret për dhënien e tendërit, mund ta shqyrtojnë mundësinë e shtuarjes së një rubrike për inkurajimin e punësimit të PAK. Kontribut në lidhje me këtë mund të japë edhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, veçmas në kompanitë publike dhe publiko-private, sepse Kuvendi i ka aksionarët nëpër ato kompani. Në bashkëpunim me këto digastere, mund ta shtyejmë procesin përpara. **Komiteti** e pati propozuar një ndërhyrje me një rubrikë në aplikacionin për punësim dhe ajo është realizuar. Diçka e ngjashme mund të realizohet edhe këtu. Për aplikim në biznes apo për tendër, në rubrikë të jetë përkufizimi: PAK apo/dhe prindërit e PAK. Ekzistojnë persona nga lloje të aftësive të kufizuara që nuk mund të jenë bartës të marrëdhënies së punës, si: me çrregullime intelektuale, me autizëm, me Syndromë Dawn, etj. Në këtë rast, duhet konsideruar punësimin e prindërve të tyre;

- Është e rëndësishme të mos ngecet dhe të ecet në bazë të raportimit dhe fjalimit në Kuvendin komunal. Të vihen kontakte të vazhdueshme me përfaqësues të kompanive private dhe publike, me qëllim të përcjelljes së gjendjes reale se a kanë të punësuar apo mund të punësojnë PAK në fusha të ndryshme. Të bëhen

- takime edhe me drejtoritë komunale, me temën e punësimit, si dhe të zbatimit të legjislacionit të PAK. Institucionet komunale duhet të jenë të njoftuara për rolin e Komitetit;
- Në fushën e arsimit, po diskutohet për rritjen e numrit të asistentëve për PAK. Gjenerata e parë e asistentëve ka diplomuar. Komuna e Skënderaj veç i ka punësuar 3 asistente të fëmijëve me nevoja të veçanta. Komuna e Prishtinës pritet që në janar të hapë konkurs për pranimin e 12 asistentëve. Ndërsa, pranimi i 100 asistentëve do të jetë në gjithë Kosovën. Nga ta do të ketë: psikologë, pedagogë dhe asistentë. Qendra e Kompetencës në Ferizaj ofron studime për nivelin e pestë të kualifikimit. Janë 50 studentë duke ndjekur ligjerimin, një paralele në Prishtinë dhe një në Ferizaj. Këtë vit mbi 20 studentë kanë filluar studimet edhe në Prizren. Ata janë pranuar për nivelin e pestë të kualifikimit. Kushti bazik ka qenë shkollimi i mesëm;
 - Armend Ademi **është** certifikuar si Asistent i Gjuhës së Shenjave. E ka kaluar testin dhe pritet ta thërrasin në punë në Prizren. Një asistent aty veç është i punësuar;
 - Kërkesë e Komitetit drejtuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ka qenë për numrat e zmadhuar, mjaftueshëm të dukshëm në xhamat anësore të autobusëve të Trafikut Urban;
 - Semaforët me zë po ndodhë që nuk po funksionojnë.

Nën “Të ndryshme” u ngrit çështja e shqyrtimit të Rregullores për Subvencione të Komunës së Prishtinës, si dhe mundësitë për plotësim-ndryshimin e saj sa i përket subvencionimit të OJQ-ve për aftësinë e kufizuar. Është bërë një rregullore e re në Komunën e Prishtinës për subvencione, në të cilën për OPAK është paraparë një shumë prej 499€ brenda viti. Vetëm me një projekt mund të aplikohet në vit. Licenca dhe statuti i beneficuar do të jenë kriteret kryesore për fitimin e grantit.

Dominoi mendimi për ta mbajtur një takim me Drejtoreshën e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe me përfaqësues të OPAK-ve, për shqyrtimin e asaj rregulloreje dhe për mundësinë e ndryshimit apo plotësimit të saj. Por, paraprakisht, Komiteti ka nevojë të jetë informuar për përmbajtjen e rregullores, në mënyrë që kur të mbahet takimi me OPAK, të jetë i përgatitur.

Armend Ademi, anëtar i Komitetit, kërkoi që të lajmërohet së paku dy ditë para takimeve, në mënyrë që ta sigurojë interpretuesin. Kryesusja iu përgjigj se takimi me drejtorë nuk varet nga Komiteti, por nga agjenda e tyre dhe mund të ftohemi edhe brenda ditës.

1.5. Mbledhja e pestë e Komitetit (06.12.2018)

Në mbledhje morën pjesë: Mehreme Llumnica, Kryesuese e Komitetit, anëtarët: Ramadan Salihu, Fatime Demolli, Armend Ademi dhe Enver Hasangjekaj, si dhe Premtime Preniqi, Koordinatorë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore. Kurse, në cilësinë e të ftuarve, në mbledhje prezentuan: Munevere Qerken, përfaqësuese e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, si dhe , përfaqësues të OPAK: Ujup Rashica, Kryetar, dhe Mirsad Mulla, Administrator, nga Shoqata e të Verbërve e Prishtinës, Nysret Shillova, Drejtor Ekzekutiv i ”Klubit Dëshira”, Faruk Kukaj, Drejtor Ekzekutiv i ”HANDIKOS-it”.

Mbledhja shqyrtoi mundësinë e iniciativës për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Subvencione të Komunës së Prishtinës.

Meqenë se në mbledhje ishin të pranishëm për herë të parë përfaqësuesit e OJQ-ve të aftësive të kufizuara, Kryesusja e Komitetit i informoi këta mysafirë për përbërjen, punën dhe aktivitetet e Komitetit, si organ konsultativ komunal për çështje të aftësisë së kufizuar. Ky takim mbahet me palë të interesit që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e rregulloreve, për ta shqyrtuar mundësinë e propozimeve për ndonjë ndryshim apo plotësim eventual që ka të bëjë me subvencionimin e OPAK-ve. Për këtë takim kanë qenë të ftuar edhe Zyra e Prokurimit dhe Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës, por që ata nuk i janë përgjigjur ftesës.

Mbledhja vazhdoi në frymën e këtij debati:

- Ka pakënaqësi nga të dy palët, Komuna dhe OJQ-të, rreth mënyrës së subvencionimit të OJQ-ve në mënyrë lineare dhe pa marrë parasysh shërbimet specifike që ofrohen nga OJQ-të e aftësisë së kufizuar. Megjithatë, është mirë që është miratuar kjo Rregullore e re;

- Rregullorja është gjithpërfshirëse dhe voluminoze. Në 36 nenet që ka, ajo përmban të gjitha aspektet e ndarjes së subvencioneve pa kthim nga Komuna e Prishtinës. Ka njoftime se nga disa OJQ komunitare është kontestuar neni 2, paragrafi 5 i rregullores. Sa është e kuptueshme, ajo dispozitë është në rregull. Në qoftë se neni 7, paragrafi 3 i rregullores parasheh që subvencionet deri 500€ të jenë në mënyrë lineare, kjo nuk e përjashton mundësinë që ato OJQ apo ata subjektë juridikë të përfitojnë edhe përmes shpalljes publike që bëhet nga digasterët komunalë të Prishtinës. Qëllimi i këtij takimi ka qenë që OJQ-të t'i japin mendimet e veta rreth aspekteve që ata i tangojnë. Ky dokument parasheh subvencione për ekonomi, shëndetësi, individë me gjendje të rëndë sociale, shërim, bursa në arsim, etj. Në secilin kapitull, ku është e mundur, rregullorja parasheh forma subvencionesh për aftësinë e kufizuar;
- A bazohen subvencionet prej projekteve apo vetëm në kërkesë? - është një dilemë. P.sh. Ka organizata që kanë paraqitur dhe dorëzuar projekte tjera në komunë, me shuma shumëfish më të mëdha. Çka të nxerrim këtu – të bazohemi në kërkesë për këtë subvencion prej 500€ apo në projekt;
- Sqarimi është se vetëm ajo shumë prej 500€ është e paraparë. Tash e tutje, aplikimi për projekte do të jetë online. Të planifikuara kanë qenë 320.000€. Ka edhe raste sociale, nga të cilat, deri tani kanë qenë 3000 lëndë. Ndarja duhet të bëhet edhe për fatkeqësitë natyrore, vërshimet, zjarret, termetet, etj;
- Nuk e pengon asgjë OJQ-në që të aplikojë me projekte në komunë apo në digasterë përkatës. Shembull, dikasteri i kulturës i ka projektet e veta, shëndetësia të vetat, arsimit të vetat, etj. Qëllimi i këtij takimi, me pjesëmarrjen e OJQ-ve dhe sipas kërkesës së OJQ-ve, është që Komiteti t'i ketë parasysh edhe pikëpamjet e tyre, në rastin kur eventualisht Komiteti u propozon institucioneve kompetente ndonjë sugjerim për ndryshimin/plotësimin e kësaj rregulloreje. Komiteti pikërisht edhe e ka rolin e konsultimit të rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore që merren me PAK;
- Shuma prej 500€ si limit bie ndesh me kërkesat e komunitetit të aftësisë së kufizuar. OJQ-ve u duhet që shumicën e kërkesave të veta ta heqin prej listës, për t'iu përshtatur shumës prej 500€, për ta bërë një raport;
- Ka qenë e mundur që edhe këto 500€ të mos mirren, pasi që është fundi i vitit. OJQ-të kanë pasur edhe shpenzime më të hershme, kështu që a u paguhën me këtë edhe ato shpenzime, p.sh. të tetorit, nëntorit, etj. apo vetëm prej asaj datës që është nënshkruar kontrata, pasi që aty është cekur vetëm viti 2018;
- Paratë janë alokuar me vonesë. Edhe me vonesë të Zyrës Ligjore, rregullorja ka kaluar në gusht. E, Komuna ka menduar mundësinë më të mirë për OJQ-të. Për të mos i kushtëzuar ato dhe për t'u dhënë një hapësirë, kjo ka qenë prej 1 janarit;
- Vërehen disa mangësi në rregullore. Nuk janë përcaktuar kriteret e qarta të subvencionet. E ato kanë të bëjnë me atë se a do të shkojë kjo prapë në mënyrë lineare apo sipas shpalljes, si dhe a do të vlerësohet projekti i aplikuesit. Po ashtu, **Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve duhet të jetë prej pesë anëtarëve, shërbyes civilë, një duhet të jetë zyrtar i financave dhe një anëtar duhet të jetë nga shoqëria civile, që ka fushëveprim të ngjashëm me fushën që do të ndahet subvencioni.** Pyetja është se a do të jetë anëtar nga e njëjta OJQ apo do të ndërrohet;
- Anëtarët e komisionit i cakton Kryetari i Komunës;
- Nuk mund të krahasohen projektet e HANDIKOS-it, të shoqatës së të verbërve, të "Klubit Dëshira". Secili i ka specifikat e veçanta. Ndoshta "HANDIKOS-i" zakonisht i ka marrë grantet, pasi që e ka mënyrën organizative dhe çmimet e projekteve më të mira. Por, ka raste kur është bërë shpallja dhe, nëse nuk janë ndihmuar nga një organizatë tjetër, "HANDIKOS-i" nuk ka pasur mundësi t'i ketë 3 a 4 oferta të përbashkëta në Komunë për projekt të caktuar. E kjo do të ishte njëra prej kriterëve. Po ashtu, tash ka dalë që organizatat duhet të jenë të licencuara. Klubi Dëshira, si organizatë, nuk është i licencuar. Komuna ka për të përkrahur më shumë, kur ka projekte të paraqitura në grup të përbashkët. Janë interesat të jo vetëm një shoqate, por të të gjitha shoqatave;
- Gjithsej, 20 organizata kanë aplikuar dhe janë përkrahur nga Komuna;
- Kjo është **rregullore për ndarjen e mjeteve financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për persona fizikë dhe juridikë** përgjithësisht në fushat e parapara dhe nuk është vetëm për PAK. Nëse rrjedh iniciativa dhe propozimi për hartimin e ndonjë rregulloreje tjetër për subvencionimin e vetëm PAK dhe organizatave të tyre, atëherë ka mundësi që në një takim tjetër ta shqyrtojmë atë ide. Do të ishte mirë të ishin së paku ca kriteret minimale gjatë shqyrtimit të aplikacionit, në mënyrë që të mos aplikojnë edhe

ato OJQ që i kanë ndoshta vetëm 3 anëtarë. Kësisoj, numri i OJQ-ve komunitare që aplikojnë bëhet voluminoz, ndërsa buxheti për subvencionim është i vogël. Drejtoria për Mirëqenie Sociale në këtë rast më shumë ka të bëjë me individë se sa me OJQ, të cilat janë të lidhura më shumë me digasterë tjerë, kulturë, sport, administratë, etj;

- Sa i përket pyetjes rreth përbërjes së **Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve, në të cilin pos shërbyesve civilë, një anëtar duhet të jetë nga shoqëria civile, që ka fushëveprim të ngjashëm me fushën që do të ndahet subvencioni, është plotësisht në rregull.** OJQ-të për komunën janë ligjërisht të barabarta, si ato të aftësive të kufizuara, si ato që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si një OJQ tjetër. Prandaj, cilëndo prej tyre ta ketë të përfaqësuar në këtë komision kjo është në rregull;
- Rregullorja është gjithpërfshirëse dhe nuk ka nevojë ta iniciojmë një të veçantë, por që të iniciohet plotësimi apo ndryshimi i saj. P.sh. te kriteret, mbeti ajo amullia se cilat do të jenë, me çfarë projekti të aplikohet, si është në subvencionet tjera, etj;
- Institucionet arsimore, ku ka fëmijë me nevoja të veçanta, nuk përkrahen në subvencione të tilla as nga Ministria e Arsimit as nga Komuna. Janë përkrahur para disa viteve, por Ministria e Arsimit ua ka deleguar kompetencat drejtorive komunale të arsimit. Dhe mund të thuhet se ka 4-5 vite që nuk ka kurfarë subvencioni në raporte me numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore;
- Te subvencionet për arsim, ka bursa, trafik, trafik individual, me siguri edhe për nxënës me nevoja të veçanta. Realisht, Ministria e Arsimit i ndan subvencione Drejtorisë Komunale të Arsimit në raport me numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- A ka mundësi OJQ-ja të aplikojë më shumë se një herë në vit, si dhe, kur më shumë drejtori bëjnë shpallje publike, nëse një OJQ komunitare e ka marrë një subvencion për një projekt, a ka të drejtë të aplikojë me ndonjë projekt tjetër në një fushë tjetër. Apo, a mund të aplikohet njëkohësisht për dy a më shumë projekte të fushave të ndryshme brenda shpalljeve publike nëpër digasterët përkatës? – rrodhi si pyetje;
- Është edhe çështja tjetër. Mos po aplikojnë në të njëjtën kohë edhe zyrat qendrore të OJQ-ve më të mëdha. Kjo është gabim. Në kuadër të këtyre kriterëve, rekomandojmë që të ndryshohet kjo praktikë;
- Ka organizata që po japin shërbime ditore dhe shumë specifike, por ka organizata që janë vetëm në letër. Duhet specifikuar qart kjo, sepse është padrejtësi e madhe të barazohet një OJQ që i ka 1000 anëtarë dhe që jep shërbime, me një OJQ që nuk jep shërbime fare. Është dëm ky edhe për vetë komunën, për komunitetin, si dhe për taksapaguesit e kësaj komune. Si ka mundësi që një OJQ komunitare e nivelit qendror të aplikojë për subvencione në komunë, kur ato e kanë rrugën e hapur nëpër ministrinë, në Qeveri, etj. Ato aplikojnë në dy a më shumë vende, kurse ne që e kemi bazën këtu dhe nuk kemi ku tjetër të drejtohem, mbesim pa donacione;
- Edhe Forumi i Aftësisë së Kufizuar, pjesë e të cilit jemi, aplikon këtu për subvencione;
- Nëse shembull “Klubi Dëshira“ aplikon për një subvencion në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, a kanë të drejt OJQ-të tjera komunitare të aplikojnë me projekte tjera të fushave tjera;
- Sipas ligjit, janë dy lloj të OJQ-ve: fondacionet dhe shoqatat. Shoqatat janë OJQ të anëtarësisë. Prandaj, tek subvencionimi, a do të kërkohet kriteri i numrit të anëtarësisë së një OJQ-je komunitare apo cilësia e projektit që ofron ajo OJQ. Kriteri i cilësisë së projektit s’ka të bëjë me atë se sa anëtarë i ka OJQ-ja, por sa është projekti cilësor sipas vlerësimit të komisionit.

** Duke pasur interesim të madh për ta shoshitur më datajshist Rregulloren për Subvencione, si dhe për shkak të nevojës për konsulta tjera, me koncensus, u vendos që në takimin tjetër të ftohen edhe përfaqësues nga: Zyra Ligjore, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Arsimit.*

Vazhdimi i mbledhjes së pestë të Komitetit (19.12.2018)

Sipas vendimit të mbledhjes së Komitetit, të mbajtur më 06.12.2018, u mbajt vazhdimi i kësaj mbledhjeje, ku, përveç anëtarëve të Komitetit, morën pjesë edhe përfaqësuesit e OJQ-ve të aftësisë së kufizuar: HANDIKOS – Faruk Kukaj, Shoqata e të Shurdhërve – Armend Ademi, Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve e Prishtinës - Ejup Rashica dhe Mirsad Mulla, Klubi Dëshira – Nusret Shillova, Syndrom Dawn Kosova – Arneta Hoxha.

Temë debati në këtë takim kanë qenë dispozitat e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve nga Komuna e Prishtinës të cilat kanë të bëjnë me subvencionimin e OJQ-ve të aftësisë së kufizuar.

Në mënyrë koncensuale, për institucionet kompetente komunale, takimi nxorri këto rekomandime:

1. Në rast të aplikimit për subvencione nga një OJQ e aftësisë së kufizuar e nivelit komunal dhe OJQ-ja tjetër e të njëjtës aftësi të kufizuar, por e nivelit qendror, nën të njëjtat kushte dhe kriteret, përparësi absolute t'i ipet OJQ-së komunale.

2. Komisioni për Ndarjen e Subvencioneve, në përbërjen e vet, të ketë edhe një përfaqësues nga komuniteti i aftësisë së kufizuar.

3. Duke qenë se themelimi i OJQ-ve është fare formal, ashtu që si pasojë ka shumë OJQ në Prishtinë, përzgjedhja për subvencionim të një OJQ-je të aftësisë së kufizuar të bazohet në këto kriteret:

3.1. Numri i anëtarësisë;

3.2. Cilësimi i projektit të prezantuar për subvencion;

3.3. Respektimi i normave ligjore dhe normative mbi të cilat funksionon OJQ-ja;

3.4. Përputhshmëria e projektit me nevojat e komunitetit që përfaqëson OJQ-ja;

3.5. Ofrimi i shërbimeve specifike.

1.6. Mbledhja e gjashtë e Komitetit (27.12.2018)

Në mbledhje morën pjesë: Mehreme Llumnica, Kryesuese e Komitetit, anëtarët: Ramadan Salihu, Fatime Demolli – Mustafa, Armend Ademi dhe Enver Hasangjekaj.

Në këtë mbledhje u debatua për rezultatet e punës së Komitetit, sfidat dhe ecurinë e iniciativave dhe aktiviteteve për vitin 2019.

Sa i përket punës së Komitetit, Mehreme Llumnica, kryesuese, theksoi se, bazuar në Planin e Punës, që e kemi miratuar këtu në fillim të vitit, do t'i paraqesim para jush rezultatet, por edhe ngecjet në realizimin e tij, si vijon:

Ngecjet

- Nuk kemi arritur ta organizojmë tryezën e rrumbullakët për zbatueshmërinë e legjislacionit për PAK, por mendoj se është plotësuar me raportin mbi të gjeturat nga hulumtimi i punësimit të PAK në tregun e punës në Komunën e Prishtinës dhe me fjalimin në Asamblenë Komunale të Prishtinës.
- Turniri i shahut, për 12 Qershorin – Ditën e Çlirimit të Prishtinës, nuk është realizuar. Në të ardhmen do ta organizojmë, pasi që tash më e dijmë ecurinë e procedurave për sponsorizim. Kemi menduar që ky aktivitet të jetë tradicional dhe të mbahet çdo vit. Turniri i shahut, që edhe është në Plan të Punës, e ka edhe simbolikën e vet dhe të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar e kanë përkrahur si ide të mirë që i ofron dhe i bën konkurrentë në mes veti.
- Nuk është realizuar as vizita entiteteve homologe jashtë vendi, për mungesë të donacioneve. Mirëpo, bazuar në premtimin e një zyrtari komunal dhe të një asambleisti këtu, mbesim në pritje që gjer në muajin mars do të qartësohet dhe konkretizohet kjo iniciativë. Mirëpo, ne duhet të jemi të gatshëm me përgatitjen e një projekti të detalizuar lidhur me këtë.

Rezultatet

- Komiteti ka mbajtur takime të rregullta, takime joformale dhe takime me zyrtarë të ndryshëm komunalë, si dhe takime: me Drejtorin e Qendrës së Karrierës, e cila është në kuadër të Komunës së Prishtinës, dhe me Drejtorin e “Trafikut Urban”.

- Kemi dalë me një raport mbi të gjeturat e hulumtimit për punësimin e PAK, që ka qenë iniciativë e "HANDIKOS-it", në të cilin hulumtim kanë marrë pjesë anëtarët e Komitetit dhe nga një anëtar i OJQ-ve prej secilës aftësi të kufizuar. E kemi prezantuar atë raport në Asamblenë Komunale, bashk me rekomandimet, të cilat janë miratuar aty në asamble.

- Duke pasur në prioritet punësimin, jemi me idenë të një takimi me Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, me Zyrën e Prokurimit, si dhe me Zyrën Ligjore, me qëllim të gjetjes së një mundësie që, kur të shpallen tenderët, prej kompanive që aplikojnë, të kenë një përparësi për përzgjidhje ato kompani që kanë të punësuar apo zotohen të punësojnë PAK.

- Sa i përket rezultateve, ndër sukseset më të dukshme është Plani i veprimit, i cili është ndërtuar dhe miratuar nga përfaqësuesit e OJQ-ve të të gjitha aftësive të kufizuara, nga Komiteti dhe nga përfaqësuesit e Kryetarit të Komunës së Prishtinës. Ai dokument është miratuar edhe në Asamblenë e Komunës së Prishtinës, por askush nuk po merret me të. I bie edhe Komitetit të merret me fatin e tij.

- Në takimin me Drejtorin Ekzekutiv të "Trafikut Urban" kemi rregulluar lirin nga pagesa e udhëtimit të PAK në qytet, por ka mbetur pa u trajtuar kërkesa për vendosjen e numrave të zmadhuar për persona me të parë të dobësuar.

Propozimet dhe idetë për vitin 2019

Fokus i planit për vitin e ardhshëm janë hapat e Komitetit për monitorimin e Planit të Veprimit. Për monitorim të tillë duhet të bashkëpunojmë me organizata të shoqërisë civile, të cilat e shtyejnë këtë proces, siç janë: KDI, OSBE, etj.

Bashkëpunimin me institucione, me individë dhe me organizata që merren me monitorimin e zbatimit të ligjit e parasheh edhe plani i punës. Janë përmendur Avokati i Popullit, Këshilli për të Drejtat e Njeriut, etj. Kjo është sipas detyrës që e kemi, por edhe mundësi për të gjetur donatorë.

Për donacion, kemi pasur problem për vizita studimore, për shkakun se nuk na lejohet të kemi xhirollogari. Por, nëse mundet KDI që me ndonjë projekt të vetin ta shtyejë këtë çështje. Neve, si këshillëdhënës që jemi në komunë, nuk na shkon fjala si atyre që bëjnë trysni me raportime dhe me vetë faktin që bashkëpunojnë me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe organet tjera në nivel qendror.

Kur ka partneritet apo bashkëpunim, donatori është edhe më dorëlibër për të dhënë donacion. Komiteti duhet t'i drejtohet KDI me kërkesë që është një Plan i Veprimit për PAK, i cili ende s'ka filluar së zbatuari dhe Komiteti nuk i ka kapacitetet për monitorimin e zbatimit të atij plani, ndaj, a ka mundësi që në një projekt të përbashkët me neve apo me komunën të monitorohet zbatimi i atij plani?

Sa i përket fëmijëve, janë organizatat UNICEF dhe Save the Children. Për fëmijë është investuar shumë në organizata. Është edhe organizata KOMF Kosova, e cila bashkëpunon edhe me nivelin lokal. Është edhe Ligji kundër Diskriminimit. Ne mund të takohemi me donatorë dhe me zyrtarë, për t'ua rikujtuar iniciativat p.sh. për rritjen e numrit të asistentëve, meqë është miratuar Ligji.

Ne jemi organ komunal dhe nuk kemi asgjë në dorë. Krejt donacionet bëhen përmes OJQ-ve, të cilat, për arsye të ndryshme, nuk funksionojnë ashtu siç duhet. Veç në autizëm janë 4-5 shoqata, çka është e tmerrshme. Ne si organ komunal nuk jemi në gjendje të dijmë se çka po bëhet, si po funksionojnë ato, çka po organizojnë, etj.

Çka kemi bërë për këto 3 vjet? Ka lëvizur diçka, por prapë nuk është e kënaqëshme sa duhet. Çka në vitin 2019? Cilat janë prioritetet, nëse veç gjer në mars të vitit 2019 i kemi kontratat? Nga takimi i parë i Komitetit presionin më të madhe e patëm bërë në Drejtorinë Komunale të Arsimit, sa i përket përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përmirësimit të infrastrukturës për ta. Mund të themi që viteve të fundit nuk është investuar sa duhet në këto aspekte. Edhe nëse ka pasur investime, ato nuk janë konkrete dhe nuk e kanë përmirësuar gjendjen e tyre.

Në kopshtin më të madh në Komunën e Prishtinës, me mbi 400 fëmijë, nuk ka infrastrukturë për fëmijët me nevoja të veçanta. Aty nuk ka qasje adekuate, nuk zhvillohet së paku ndonjë aktivitet, është numër i madh i fëmijëve, mungojnë asistentët, etj. Është mirë të bisedohet me Drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit, që së paku t'u bëhet e mundur studentëve të psikologjisë, pedagogjisë apo të edukimit, ta ushtrojnë praktikën e punës në këto institucione. Ka të tilla që nuk kanë as edukatorë as pedagogë.

Ajo që është shqetësuese është fakti që, për 3 vite Komiteti nuk ka arritur të takohet me Kryetarin e Komunës. Thirrëmi se jemi organ për të dhënë konsulta ... Kujt?! Kujt po i sugjerojmë gjithë këto rekomandime, ku dhe tek kush po i adresojmë ato?

Si Komitet, kemi hasur në bashkëpunim të mirë me Drejtorin e Drejtorisë së Administratës, z. Muhedin Nushi, i cili na ka përkrahur që nga fillimi, sikurse edhe Avni Zuka, Menaxher i Burimeve Njerëzore.

Por, meqenë se e kemi mandatin gjer në mars, varsisht se a do të ketë ndonjë ndërrim, shuarje të Komitetit apo vazhdim të mandatit, t'i zgjedhim së paku dy prioritetet të Planit të Veprimit, në fushën e arsimit dhe në fushën e punësimit. Tek e fundit, punësimi është paraqitur si çështje prioritare edhe në raportin me rekomandime që e kemi prezentuar dhe është miratuar në Asamblesh Komunale të Prishtinës. Plani i Veprimit i parasheh edhe asistentët edhe mësuesit mbështetës, përfshirë edhe të Gjuhës së Shenjave. Ka komuna që nuk kanë fare këtë lloj të komitetit.

Nën “Të ndryshme”, Armend Ademi ngriti për diskutim çështjen e liritimit nga pagesa e biletës sipas ligjit në trafikun ndërrurban. Ai informoi se ka biseduar me drejtorin, Muhedin Nushi, i cili i ka shprehur gatishmërinë për një takim lidhur me çështjet e ngritura.

Por, kryesuesja u përgjigj se kjo çështje i përket nivelit qendror të qeverisjes, sikurse që edhe është përgjegjësi e Forumit të Aftësive të Kufizuara, i cili duhet t'i marrë këto iniciativa për jashtë Prishtinës. Forumi është ambrella për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar. Ide e imja është që të takohemi si Komitet me Forumin dhe aty ta ngrisim edhe këtë çështje.

Po, nëse është caktuar takimi me drejtorin Muhedin, ne mund të shkojmë dhe besoj se kemi tema për çka të flasim. Mund ta ngrisim edhe këtë çështjen e shtyerjes së punësimit të PAK në Komunën e Prishtinës, të cilën çështje kemi dashur ta trajtojmë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me Zyrën e Prokurimit dhe me Zyrën Ligjore.

U vendos që:

** Të përgatitet Raporti vjetor për punën dhe aktivitetet e Komitetit gjatë vitit 2018, gjer kah mesi i muajit janar të vitit 2019.*

** Raporti të dërgohet për publikim në linkun e Komitetit, në Web-faqen e Komunës.*

2. TAKIMET

Gjatë vitit 2018, Komiteti ka zhvilluar më së pesë takime me zyrtarë të institucioneve të Komunës së Prishtinës dhe me udhëheqës ndërmarrjesh publike. Në këto takime, përveç njohjes së ndërsjellë të Komitetit me digasterë komunalë dhe publikë, është biseduar për aspekte të ndryshme të realizimit të të drejtave ligjore të PAK në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe me rregullativën lokale për të drejtat e këtyre personave.

Megjithse rezultatet e takimeve të mbajtura janë larg së dëshiruarës, mund të konstatojmë se është hapur rruga e komunikimit për zgjidhjen e problemeve që e tangojnë komunitetin e aftësisë së kufizuar.

2.1. Takimi me Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

Më 20 mars 2018, Mehreme Llumnica, në cilësinë e Kryesueses së Komitetit dhe Ramadan Salihu, në cilësinë e anëtarit, kanë zhvilluar një takim me Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, z. Yll Rugova, në të cilin takim është biseduar për mundësinë e sponsorizimit të një turniri të shahut me rastin e 12 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Prishtinës. Ky turnir, nën organizimin e Komitetit, do të zhvillohej mes shahistëve nga OJQ-të e aftësive të kufizuara, në të cilat shahu është pjesë e aktiviteteve të tyre. Turniri metohet të jetë tradicional.

Drejtori e përkrahu këtë iniciativë dhe u zotua se do ta ketë në konsideratë kërkesën e Komitetit, kur ajo të procedohet në kohën e shpalljes publike, e cila publikohet në faqen zyrtare të internetit në komunë.

Veç kësaj, në takim u bisedua edhe për mundësimin e punësimit të PAK në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, gjithnjë në vazhden e zbatimit të dispozitave ligjore që e përcaktojnë këtë punësim. Drejtori shprehu gatishmërinë të mbetemi në konsulta të përhershme mes Drejtorisë dhe Komitetit në kuptim të gjetjes së formës dhe mundësisë për kryerjen e këtij obligimi ligjor.

2.2. Takimi me menaxhmentin e NP “Trafiku Urban”

Në emër të Komitetit, Mehreme Llumnica, kryesuese, Armend Ademi dhe Ramadan Salihu, anëtarë, më 20 qershor 2018 janë takuar me Drejtorin Ekzekutiv të NP “Trafiku Urban”, z. Lulëzim Rexhepaj dhe me Sekretarin, z. Florim Krasniqi. Temë e këtij takimi ka qenë shqyrtimi i mundësisë së lirimit të PAK dhe shoqëruesve të tyre nga pagesa e udhëtimit në linjat urbane, ashtu siç parashihet edhe me dispozita ligjore.

Nikoqirët shfaqen mirëkuptim për kërkesat tona të arsyeshme, por edhe shprehen rezerva sa i përket saktësisë së identifikimit të udhëtarëve me status të përnjëmendët të PAK. Drejtori dhe sekretari potencuan se ka jo pak udhëtarë që prezantohen si PAK, por nuk japin kurrfarë shenjash se janë të tillë. Lëshimi i librezave identifikuese kredibile nga institucionet apo shoqatat e PAK do t’u ndihmonte konduktorëve për një qasje të drejtë ndaj PAK. Menaxhmenti i ndërmarrjes në asnjë mënyrë nuk ka për qëllim t’ua mohojë PAK lehtësirat për udhëtim që ua njihet ligji, veç se është kundër që të abuzohet me këtë, përçka edhe pret bashkëpunimin me Komitetin dhe me OJQ-të në këtë drejtim.

Vlen të theksohet këtu se, në një kohë rekorde, prej rreth një jave, përmes postës elektronike ka ardhur konfirmimi i Drejtorit Ekzekutiv të NP “Trafiku Urban” se vendimi për lirim nga pagesa e udhëtimit të PAK është marrë dhe është shpërndarë nëpër autobusët e Trafikut Urban.

Një vendim i tillë po zbatohet dhe ky është një sukses i përbashkët i Trafikut Urban dhe i Komitetit.

2.3. Takimi me Kryesuesin e Asamblesë Komunale të Prishtinës

Me z. Agim Kuleta, Kryesues i Asamblesë Komunale të Prishtinës, Komiteti është takuar më 12 shtator 2018. Në atë takim, nga ana e komunës mori pjesë edhe z. Osman Bllaca, Zyrtar i Prokurimit, kurse prej Komitetit ishin Mehreme Llumnica, kryesuese, dhe ramadan Salihu, anëtar.

Kërkesa nga ana e Komitetit ishte që Asamblea Komunale e Prishtinës ta shqyrtojë mundësinë e futjes në rend të ditës së asamblesë raportimin rreth një hulumtimi për punësimin e PAK në punëdhënësit publik dhe privat në Komunën e Prishtinës, të financuar nga **KSCF dhe të implementuar nga HANDIKOS-i në bashkëpunim me Komitetin.**

Ideja e këtij prezantimi është sensibilizimi i asambleistëve dhe i opinionit për një realitet të hidhur të PAK në territorin e Komunës së Prishtinës, sa i përket punësimit, si një e drejtë e garantuar me ligj.

Zotri Kuleta shfaqti një gatishmëri të veçantë për realizimin e kësaj ideje dhe u zotua se në konsulta të përbashkëta të gjindet mënyra dhe momenti që këtij prezantimi t'i ofrohet mundësia për bujë sa më të madhe, përfshirë këtu edhe mediet që e mbulojnë punën e asamblesë.

Prezantimi i raportit është realizuar, duke i dhënë madje mundësinë përfaqësuesit të Komitetit ta mbajë një fjalim përpara asambleistëve në lidhje me të gjeturat e këtij raporti.

Përfaqësuesit e Komitetit, Mehreme Llumnica, Enver Hasangjekaj dhe Ramadan Salihu, kanë qenë të pranishëm në mbledhje, duke u trajtuar dinjitetshëm nga asambleistët, sikur që edhe dinjitetshëm që është bërë edhe fjalimi nga ana e përfaqësuesit të Komitetit.

2.4. Takimi me Drejtoreshën e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale

Enver Hasangjekaj, Mehreme Llumnica dhe Ramadan Salihu, përfaqësues të Komitetit, më 3 tetor 2018, vizituan Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për të biseduar me Valbona Osmani, drejtoreshë në këtë drejtori, në lidhje me punësimin e PAK në këtë digaster dhe në lidhje me subvencionimin linear të OJQ-ve të aftësisë së kufizuar.

Drejtoresha i njoftoi përfaqësuesit e Komitetit se subvencionet në fjalë, në mënyrë lineare në shumën prej rreth 500€ u ndahen të gjitha OJQ-ve që aplikojnë për atë subvencion dhe që i plotësojnë kriteret e parapara nga Rregullorja për Subvencione në Komunën e Prishtinës, e cila është miratuar dhe ka hyrë në fuqi më 06.08.2018. kjo rregullore përcakton që subvencionet që nga viti i ardhshëm të ndahen përmes shpalljeve publike, të cilat janë në kompetencë edhe të drejtorive tjera komunale të Prishtinës.

Sa i përket punësimit të PAK, drejtoresha sqaroi se ky digaster ka pësuar ndryshime, në mënyrë që nga një drejtori kanë dalë dy sosh në vete. Tash më Drejtoria e Shëndetësisë nuk është më në kuadër të kësaj drejtorie dhe ajo funksionon në vete. Kësisoj, në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale ka mbetur një staf prej 36 shërbyesve civilë, ndaj dhe ende nuk e ka arritur numrin për atë kuotën një PAK në pesëdhjetë të punësuar.

Komiteti është në përkrahje të OJQ-ve të aftësisë së kufizuar që në rregullore të përcaktohen kriteret më strikte për subvencionim të OJQ-ve komunitare, në mënyrë që këtë shumë lineare të mos e përfitojnë edhe ato OJQ, të cilat nuk janë aktive për komunitetin dhe nuk kanë anëtarësi apo kanë një numër simbolik të anëtarësisë.

U dakordua që në hapat e mëtejshëm të mbesim në komunikim sa i përket temave të ngritura.

2.5. Takimi me Zyrtaren e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

Z. Mevlude Zejnullahu, Zyrtare e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ishte adresa në vijim dhe e fundit me të cilën Komiteti, në përbërje prej Mehreme Llumnicës dhe Enver Hasangjekajt, zhvilloi takim më 6 dhjetor 2018. Arsyeja e kësaj vizite ka qenë riaktualizimi i çështjes së një vizite pune të Komitetit entiteteve homologe jashtë vendi, temë kjo që edhe më përpara ka qenë pjesë e debatit në mbledhje të Komitetit, ku ka qenë prezente edhe zonja Zejnullahu, e cila edhe përfaqëson një digaster të rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm, çka mund të japë një kontribut në temat e ngritura.

Zyrtarja njoftoi se e ka paraqitur këtë çështje në dy adresa të mundshme dhe ka hasur në mirëkuptim që gjatë tremujorit të parë të vitit të ardhshëm kjo ide të fillojë të jetësohet. Janë dy biznese që kanë shfaqur gatishmëri t'i dalin në ndihmë Komitetit me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tij në fushëveprimin e tij për çka edhe është i mandatuar.

Komiteti e çmon dhe e vlerëson angazhimin e zonjës Mevlude Zejnullahu për qasjen ndaj PAK në përgjithësi dhe përmirësimin e statusit të tyre shoqëror, si dhe në veçanti për rritjen e performancës së Komitetit.

(III)
PJESA PËRMBYLLËSE

KONKLuzionET ME REKOMANDIME

Në periudhën gati trivjeçare të funksionimit të Komitetit dhe sipas këtij raporti mund të konstatohet se problemet e PAK në Komunën e Prishtinës janë të shumta, me theks të veçantë, në punësim, temë kjo e cila i prek më së shumti PAK.

Megjithatë, Komiteti njih një gatishmëri më të madhe të institucioneve komunale të Prishtinës për t'i përmbushur obligimet ligjore për PAK, por thirren në kufizimet ligjore dhe buxhetore në realizimin e të drejtave të PAK, veçmas në sferën e punësimit.

Mbështetur edhe në të cekurat e raportit, Komiteti nxjerr këto rekomandime:

- ◆ Punëdhënësit në nivelin lokal të jenë fokusi primar i avokimit për zbatim të kornizës ligjore për punësimin e PAK, e cila kornizë përcakton qart formën dhe mundësinë për punësimin e tyre.
- ◆ Të promovohen lehtësirat ndaj kontraktorëve biznesorë që kanë apo zotohen të punësojnë PAK, sipas legjislacionit dhe Planit të veprimit 2018-2020, për PAK në Komunën e Prishtinës.
- ◆ Anëtarët e Komitetit ta rrisin ndikimin e tyre të zyrtarët komunalë për punësim më të madh të PAK dhe për sigurimin e të drejtave të barabarta sociale.